VENDIM
Nr. 873, datë 27.12.2022

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE ELEMENTEVE TË PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË PROJEKTUESIT, TË GRUPIT TË PROJEKTIMIT DHE ZBATUESIT TË PUNIMEVE, SI DHE RREGULLAT DHE ELEMENTET E SIGURIMIT, TË PËRGJEGJËSISË SË ZHVILLUESIT PËR TË GJITHA NDËRTIMET ME VLERË MBI 100 MILIONË LEKË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, pika 9, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 3/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
KUSHTET DHE ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË PROJEKTUESIT DHE GRUPIT TË PROJEKTIMIT

Neni 1

Projektuesi si person fizik apo juridik, i licencuar, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ndërtimit të objektit.

Neni 2

Shuma e sigurimit llogaritet duke mbuluar të paktën dëmet e mëposhtme:

a) Çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e gabimeve në projektim;

b) Kostot shtesë që mund të lindin për zhvilluesin, si pasojë e gabimeve në projektim gjatë zbatimit të projektit.

Neni 3

Limiti i përgjegjësisë dhe shuma e sigurimit të kontratës së sigurimit përcaktohet në policën e sigurimit dhe nuk mund të jetë më e ulët se shuma e sigurimit, sipas nenit 2, të këtij vendimi.

Neni 4

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen në vlerë monetare të siguruarin/përfituesin për dëmet që ai ka pësuar, si pasojë e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Dëmshpërblimi nuk kalon në asnjë rast limitin e përgjegjësisë të caktuar në policën e sigurimit.

Neni 5

Polica e sigurimit duhet të jetë e përcaktuar për objektin e punimeve, për të cilin projektuesi apo grupi i projektimit siguron profesionin e tij, sipas përcaktimeve në lejen e zhvillimit ose ndërtimit.

Neni 6

Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, që lidhet pranë shoqërive të sigurimit nga projektuesi apo grupi i projektimit, është e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë, nga data e lidhjes së kontratës ndërmjet zhvilluesit dhe projektuesit apo grupit të projektimit, deri në datën e certifikimit të objektit.

Neni 7

1. Shoqëria e sigurimit lidh kontratën e sigurimit, me kusht që të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

a) Personi fizik apo juridik të jetë i pajisur me licencë për projektimin e punimeve që do të realizohen nga institucioni, që ka në fushën e veprimtarisë licencimin për projektimin, me kategoritë që i përgjigjen projektimit të punimeve, që do të duhen për realizimin e projektit të plotë të zbatimit;

b) Personi fizik apo juridik i pajisur me licence për projektimin të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar dhe i pajisur me NIPT;

c) Personi fizik apo juridik projektues të ketë kontratën me zhvilluesin të firmosur nga projektuesi, në rastin e personit juridik nga përfaqësuesi juridik i tij, si dhe përfaqësuesi i zhvilluesit.

2. Për dëmtime të ndodhura në objekt, si pasojë e gabimeve së projektuesit gjatë procesit të projektimit dhe ndryshimeve të projektit të miratuara nga zhvilluesi, që lindin si domosdoshmëri gjatë procesit të ndërtimit të objektit, shoqëria e sigurimit detyrohet të dëmshpërblejë të siguruarin/përfituesin, të paktën për dëmet e mëposhtme:

a) Për shpenzime të nevojshme e të domosdoshme të projektimit të ri, si dhe shpenzimet shtesë për ripunimin e projektit, të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike;

b) Për kostot shtesë që mund të lindin për zhvilluesin gjatë zbatimit të projektit për shkak të defekte në projekt.

Neni 8

Kushte dhe elemente të posaçme shtesë të sigurimit përcaktohen në kontratën e sigurimit.

KREU II
KUSHTET DHE ELEMENTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË ZBATUESIT TË PUNIMEVE

Neni 9

Zbatuesi i punimeve si person juridik, i licencuar, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ndërtimit të objektit.

Neni 10

Shuma e sigurimit llogaritet duke mbuluar të paktën çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja, si dhe shpenzimet shtesë të kryera nga zhvilluesi ose organet e administratës publike, që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të punimeve në

kundërshtim me kontratën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, me dokumentet e planifikimit dhe zhvillimit, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit.

Neni 11

Limiti i përgjegjësisë/shuma e sigurimit të kontratës së sigurimit përcaktohet në policën e sigurimit dhe nuk mund të jetë më i ulët se shuma e sigurimit, sipas përcaktimit në nenin 10, të këtij vendimi.

Neni 12

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen në vlerë monetare të siguruarin/përfituesin për dëmet që ai ka pësuar, si pasojë e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Dëmshpërblimi nuk kalon në asnjë rast limitin e përgjegjësisë të caktuar në policën e sigurimit.

Neni 13

Polica e sigurimit duhet të jetë e përcaktuar për objektin e punimeve, për të cilin zbatuesi i punimeve siguron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve në lejen e zhvillimit ose ndërtimit.

Neni 14

Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale, që lidhet pranë shoqërive të sigurimit nga zbatuesi i punimeve, është e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë, nga data e lidhjes së kontratës ndërmjet zhvilluesit dhe zbatuesit të punimeve, deri në datën e certifikimit të objektit.

Neni 15

1. Shoqëria e sigurimit lidh kontratën e sigurimit, me kusht që të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

a) Personi juridik të jetë i pajisur me licencë për zbatimin e punimeve që do të realizohen nga institucioni që ka në fushën e veprimtarisë licencimin për zbatimin e punimeve, me kategoritë që i përgjigjen punimeve që do të realizohen;

b) Personi juridik i pajisur me licencë për zbatimin e punimeve të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar dhe i pajisur me NIPT;

c) Personi juridik zbatues i punimeve të ketë kontratën me zhvilluesin të firmosur nga përfaqësuesi juridik i zbatuesit, si dhe përfaqësuesi i zhvilluesit.

2. Për dëmtime të ndodhura në objekt, si pasojë e veprimtarisë së zbatuesit të punimeve gjatë procesit të ndërtimit të objektit, shoqëria e sigurimit detyrohet të dëmshpërblejë të siguruarin/përfituesin, të paktën për dëmet e mëposhtme:

a) Për çdo shpenzim të nevojshëm e të domosdoshëm për kryerjen e punimeve të reja;

b) Për shpenzimet shtesë, që kanë rrjedhur si pasojë e zbatimit të punimeve në kundërshtim me kontratën përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, me dokumentet e planifikimit dhe zhvillimit, si dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon veprimtarinë e ndërtimit.

Neni 16

Kushte dhe elemente të posaçme shtesë të sigurimit përcaktohen në kontratën e sigurimit.

KREU III
ELEMENTET E PËRGJITHSHME DHE RREGULLAT E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË ZHVILLUESIT

Neni 17

1. Zhvilluesi si person fizik apo juridik është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale për të gjitha ndërtimet me vlerë mbi 100 milionë lekë. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet nga rreziqet gjatë procesit të zhvillimit kundrejt palëve të treta.

2. Në rastin e ndërtimeve me vlerë mbi 100 milionë lekë, kur zhvilluesi është edhe zbatues, ky i fundit përjashtohet nga detyrimi për të lidhur kontratë sigurimi, sipas parashikimeve të kreut II, të këtij vendimi.

Neni 18

Shuma e sigurimit llogaritet në përqindje ndaj preventivit të punimeve të zbatimit për kostot e llogaritshme, pa vlerën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Kjo vlerë do të jetë jo më shumë se 15% e vlerës së preventivuar të punimeve.

Neni 19

Limiti i përgjegjësisë/shuma e sigurimit të kontratës së sigurimit përcaktohet në policën e sigurimit dhe nuk mund të jetë më i ulët se shuma e sigurimit, sipas përcaktimit në nenin 18, të këtij vendimi.

Neni 20

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen në vlerë monetare të siguruarin/përfituesin për dëmet që ai ka pësuar, si pasojë e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Dëmshpërblimi nuk kalon në asnjë rast limitin e përgjegjësisë të caktuar në policën e sigurimit.

Neni 21

Polica e sigurimit duhet të jetë e përcaktuar për zhvillimin, për të cilin zhvilluesi siguron dëmin ndaj palëve të treta nga zbatimi i punimeve, sipas përcaktimeve në lejen e zhvillimit ose ndërtimit.

Neni 22

Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale që lidhet pranë shoqërive të sigurimit nga zhvilluesi është e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë nga data e miratimit të lejes së zhvillimit apo ndërtimit, deri në datën e certifikimit të objektit.

Neni 23

Shoqëria e sigurimit lidh kontratën e sigurimit me zhvilluesin, me kusht që të jetë i pajisur me lejen për zbatimin e punimeve që do të zhvillohen nga autoriteti, që ka në fushën e veprimtarisë së tij dhënien e lejes së nevojshme.

Neni 24

Kushte dhe elemente të posaçme shtesë të sigurimit përcaktohen në kontratën e sigurimit.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, autoritetet e zhvillimit të territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 26

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama